



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



ARKIVA DALËSE  
IZLAZNE ARHIVE  
OUTPUT ARCHIVES

01-01/01-8543  
09062024

Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2024

Datë. 30.05.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në Rregulloren Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe nenit 15 pika 1 të Rregullores 01 nr. 110/01-3560/2020 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, të datës 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë.30.05.2024, pas diskutimeve lidhur më pikën e 4 të rendit të ditës: Propozim Vendim për mbështetje financiare të Shoqatës “Handikos Gjakova”, e miratoi këtë:

## V E N D I M

Për

### mbështetje financiare të shoqatës “Handikos Gjakova”

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës “Handikos Gjakova” sipas rekomandimit të Komisionit Vlerësues bazuar në Thirrjen Publike për Projekte dhe Programe të OJQ-ve në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për mbështetje financiare në vlerë prej 20.000€ me qëllim të përkrahjes për realizimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara që ofrohen nga “Handikos Gjakova”.
2. Mjetet financiare për Shoqatën “Handikos Gjakova” ndahen nga Kategoria e Subvencioneve Komunale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga Kodi buxhetor: 21/632/73950/00000/0721, në vlerë prej 20,000€.
3. Obligohen organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
5. **Vendimi iu dërgohet:**
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
  - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
  - Arkivit.

Arbëneshja Kuqi  
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

